



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-1541/20 datë: 20.01.2020



Npi – 01/38 datë: 28.01.2020

Duke u bazuar në nenin 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/149 datë: 31.05.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 28.01.2020 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -I- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

E mbajtur më datën: 28.01.2020 (e martë) në ora 10.00 h. në sallën Nr.1 të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj z.Perparim Ramusa, znj.Arbesha Sylja, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari, dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtorët, z.Muhadin Halili; Zyrtari për barazi gjinore z.Reshat Gashi; Zyrtari për Informim z.Lulzim Sahiti; Përfaqësuesi i OSBE z.Mefail Mustafa; Zyrtarët e IT-së z.Gazmend Ademaj dhe z.Shpëtim Gashi; Dhe praktikantja, znj.Fortuna Fazliu. Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i ekstrakt procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22.11.2019,
2. Propozim-vendim për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit dhe KPF-së për vitin 2020 (Pas diskutimit publik).
3. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të KPF-së për vitin 2020,
4. Raport i Punës së Kuvendit dhe KPF-së për vitin 2019,
5. Raport i aktiviteteve të Zyrës së Prokurimit gjatë vitit 2019,
6. Plan Komunal i Veprimtari për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021 (Pas diskutimit publik)
7. **Propozim-Vendim për dhënien e Veturës komunale, Stacionit të Policisë në Shtime. (Pikë shtesë)**

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapë diskutimin për rendin e ditës, propozoi që të futet edhe një pikë shtesë e rendit të ditës "Propozim-Vendim për dhënien e veturës komunale Stacionit të Policisë në Shtime". Në vazhdim hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Ruzhdi Jashari; Përshëndetje, pse e propozove këtë pikë kur kemi raste shumë më të mëdha se sa kjo çështje. unë nuk e konsideroj të nevojshme që të diskutojmë për një çështje të tillë.

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës, edhe me pikën shtesë të propozuar që të futet në rendin e ditës.

znj.Zarife Rexhaj; Përrshëndetje, pajtohem me rendin e ditës, edhe me pikën shtesë të propozuar, sepse është në kuadër të transparencës.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsisht aprovoi rendin e ditës, me pikën shtesë, Propozim-Vendim për dhënien e Veturës komunale, Stacionit të Policisë në Shtime.**

Pika 1

Shqyrtimi i ekstrakt procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22.11.2019

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsisht, aprovoi ekstrakt procesverbalin nga mbledhja e mbajtur, më 22.11.2019.**

Pika 2

Propozim-vendim për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit dhe KPF-së për vitin 2020 (Pas diskutimit publik).

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Prezantoi dokumentin nga procesi i diskutimit publik i mbajtur më 22.01.2020. Mund të them se me pjesëmarrje nuk jemi të kënaqur, por nga ky takim kemi edhe disa propozime që kanë dalë, e të cilat i kemi inkuorporuar në Draft- Planin e punës, dhe janë të shkruara e të cilat po besoj që i keni marrë dhe i keni lexuar. Hapi diskutimin për këtë pikë. Nëse nuk kemi diskutime unë po e vej ne votim Draft-Planin me ndryshimet e propozuara.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsisht vendosi që ti rekomandoj Kuvendit aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit dhe KPF-së për vitin 2020.**

Pika 3

Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të KPF-së për vitin 2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Prezantoi këtë pikë, duke thënë se ky orar është harmonizuar edhe me orarin e Kuvendit.

z.Perparim Ramusa; Unë pajtohem me këtë orar për 2020, dhe jam që ta votojmë.

z.Naim Zejna; Unë po e pyes administratën se a është afat i mjaftueshëm deri te mbledhja e Kuvendit për me i përgatitur Rekomandimet që dalin nga KPF-ja.

z.Idajet Rexhepi, zyrtar i Kuvendit; Përrshëndetje, unë mund të ju sqaroj se për ne mjafton që të kemi edhe vetëm një ditë diferencë në mes mbledhjes së KPF-së dhe Kuvendit. Ne mund ti përgatisim Rekomandimet, edhe përkundër faktit se Zyra e Kuvendit që moti është në mungesë të stafit, këtë e kemi bërë të ditur disa herë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsisht aprovoi Vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të KPF-së për vitin 2020.**

Pika 4

Raport i Punës së Kuvendit dhe KPF-së për vitin 2019

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Prezantoi raportin e punës së Kuvendit dhe KPF-së duke theksuar se janë përmbushur obligimet që kemi sipas LVL-së. Në vazhdim Kryesuesja lexoi të dhënat sipas tabelave të mbajtjes së mbledhjeve dhe akteve të miratuara në Kuvend. Meqenëse raportin e keni të shkruar unë do të lë hapësirë që të bëni pyetje e të jepni ndonjë sugjerim. (Shih dokumentin)

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” dhe me 2 vota “Abstenim” aprovoi Raportin e Punës së Kuvendit dhe KPF-së për vitin 2019, dhe i rekomandon Kuvendit për aprovim.**

Pika 5

Raport i aktiviteteve të Zyrës së Prokurimit gjatë vitit 2019

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Muhadin Halilit.

z. Muhadin Halili, drejtor i DPP; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, prezantoi Raportin e aktiviteteve të Zyrës së Prokurimit gjatë vitit 2019, duke e lexuar atë. Ai tha se raportin e kemi përgatitur në formë të shkruar dhe e keni marrë me kohë, unë i mirëpres pyetjet e juaja. (Shih dokumentin).

z. Naim Zejna; Është një raport i detajuar, por unë i kamë disa kërkesa të veçanta. Është mirë që për secilin Kontratë me na i paraqitë pronarët e kompanive dhe sa projekte kanë marrë nga Komuna. Psh. kompania “Ardhmëria” nga Shtimja sa projekte ka marrë nga Komuna.

z. Ruzhdi Jashari; Plotësisht e përkrahu propozimin e Naim Zejna për ta prezantuar secilin pronarë të kompanisë si dhe numrin e projekteve që i ka fituar për secilin operatorë. Pastaj unë po kërkoj që në raport me na u prezantuar edhe punët shtesë të projekteve që janë kryer sepse ka mjaft shumë punë shtesë e që kjo tregon se aty diçka nuk është në rregull. Shpenzimi i 48.000€ për punë shtesë është tepër shumë, kjo është edhe më e keqe kur po paguhet kompani kontraktuese për planifikimin e projekteve. Dua ta pyes drejtorin se çka po nënkupton me furnizimin me veshmbathje për kënd janë paraparë, këto për të hequr dilemat? Bibliotekat e hapura kanë dështuar totalisht, ku janë shpenzuar 2-3 mijë euro. Në të gjitha projektet mungon një studim i mirëfilltë i fizibilitetit të projekteve. Konferencat e organizuara dhe të paguara bukur mirë për Arsim, kanë dështuar totalisht, po epen pare për projekte pa lidhje që po rezultojnë pa kurrfarë suksesi.

z. Perparim Ramusa; Mendoj se është një raport i mirë, ndërsa sa i përket detajeve për secilin projekt janë në dosjet e tyre, ku secili që dëshiron mund ti shikojë. Unë jam ithtarë i asaj që punimet me i kryer sa më shumë kompanitë e Komunës tonë.

z. Muhadin Halili, drejtor i DPP; Raporti i detajuar me të gjitha detajet është duke u përgatitur, mirëpo tani për tani nuk mund tua japim sepse kemi edhe 3 projekte në realizim nga Ministria e linjës. Mendoj se në fund të muajit Shkurt do ta kemi gati raportin e detajuar. Ndërsa për mbledhjen e Kuvendit më 30.01.2020 do të bëj përpjekje që këtë raport ta plotësoj edhe me disa të dhëna plotësuese. Çdo faturë që na vjen neve, ne jemi të obliguar që ta procedojmë sipas procedurave. Sa i përket furnizimit me veshmbathje ju e dini se kemi disa sektorë siç janë Pylltaria, QKMF-ja pastaj Zjarrfiksat të cilët duhet që ti furnizojmë me uniforma. Kontrata e furnizimit me dru është kontratë tre vjeçare, porositë bëhen ashtu sa ato njësi kanë nevojë për dru. Ne si drejtori e Prokurimit jemi të obliguar që me i shpallë tenderin sipas njësisë kërkuese qysh na vjen. Kemi pas 7 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” aprovoi Raportin e aktiviteteve të Zyrës së Prokurimit gjatë vitit 2019.**

Pika 6

Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021 (Pas diskutimit publik)

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Halil Halilit.

z. Halil Halili, drejtor i DSHP; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, prezantoi Planin Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021, pas diskutimit publik. Sipas vendimit të Kuvendit ne kemi organizuar diskutimin publik me qytetarë më datën 24.01.2020, ku ka pas një numër simbolik të pjesëmarrësve. Nuk ka pas ndonjë propozim konkret për Planin, ne e kemi shkruar një dokument lidhur me diskutimin publik të cilin tani ju e keni përpara, ne i mirëpresim pyetjet dhe

komentet e juaja. Ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit aprovimin e këtij Plani për Eficiencë. (Shih dokumentin)

znj.Arbresha Sylja; Përshëndetje, kërkoj falje për vonesë. E falënderoj drejtorin për elaborimin lidhur me procesin e diskutimit publik, të Planit për Eficiencë. Konsideroj se është një Plan mjaft ambicioz, edhe pse ne ndoshta nuk do të mundemi që ta zbatojmë në tërësi, por së paku e kemi bazën për të konkurruar për donacione në këtë fushë. Mendoj se ky plan është në përputhje të plotë me Planin Nacional për Eficiencë, për këtë arsye unë propozoj që ta aprovojmë dhe ti rekomandojmë Kuvendit për aprovim.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i rekomandoj Kuvendit aprovimin e Plani Komunal i Veprimtari për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021.**

Pika 7 (Pikë shtesë)

Propozim-Vendim për dhënien e Veturës komunale, Stacionit të Policisë në Shtime

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Prezantoi këtë pikë, duke lexuar Propozim-Vendim e ekzekutivit, për dhënien e Veturës komunale, Stacionit të Policisë në Shtime, në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Perparim Ramusa; Ne e votuam këtë pikë për ta futur në rendin e ditës si pikë shtesë, kështu që ne si subjekt politik i PDK-së jemi "Për" që veturën e administratës komunale me ja dhënë Stacionit të Policisë në Shtime, dhe i rekomandojmë Kuvendit që ta aprovoi këtë vendim.


znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, unë nuk jam për mos me bashkëpunuar me Policinë, por unë e kam përmendur edhe më herët se edhe Qendra për Punë Sociale, e ka gjendjen shumë të keqe për një automjet, bile po rrezikohet edhe jeta e punëtorëve social me një automjet të vjetër që është në përdorim, prandaj unë po propozoj që këtë veturë me ja dhënë Qendrës për Punë Sociale.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i rekomandoj Kuvendit aprovimin e Vendimit për dhënien e Veturës komunale, Stacionit të Policisë në Shtime.**

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesja, mbledhjen e përfundoi ne ora 11.03h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj

